Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija--*
*Ministry of Education Science andTechnology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV: Nr.26/2013 ZGJEDHJA E NËPUNËSVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PROFESIONALE NË INSTITUCIONET EDUKATIVE-ARSIMORE PARAUNIVERSITARE**

**ADMINISTRATIVNE UREDBE : BR.26/2013 IZBOR SLUŽBENIKA ZA PRUŽANJE PROFESIONALNIH USLUGA U PREDUNIVERZITETSKIM EDUKATIVNO-OBRAZOVNIM INSTITUCIJAMA**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION: No.26/2013 SELECTION OF EMPLOYEES FOR PROVISION OF PROFESSIONAL SERVICES IN PRE-UNIVERSITY INSTRUCTIVE-EDUCATION INSTITUTIONS**

| | | |
|---|---|---|
| Në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 17 / 16 shtator 2011) Në pajtim me shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03. 2011) dhe nenin 38 (6) te rregullores së punës së Qeverisë Nr. 09/2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë :<br><br>**UDHËZIM ADMINISTRATIV**<br><br>**Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative – arsimore parauniversitare**<br><br>**NUMËR:** 26.2013<br>**DATË:** 18.06.2013<br><br>**Neni 1**<br>**Qëllimi**<br><br>Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është zgjedhja e nëpunësve profesional, për të ofruar shërbime profesionale të cilat përfshijnë kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike- psikologjike dhe shërbimeve këshilluese e sociale. | Na osnovu člana 37 stav 1 i 2 Zakona o Preduniverzitetskom obrazovanju u Republiku Kosova, (Službeni glasnik br. 17 / 16 septembar 2011). U skladu sa dodatkom 6 Pravilnika br. 02/2011 za oblast administrativne odgovornosti Kancelariji Premijera i ministarstva (22.03.2011) i člana 38 (6) Pravilnika rada Vlade br. 09/2011 , Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije izdaje ovu:<br><br>**ADMINISTRATIVNE UREDBE**<br><br>**Izbor službenika za pružanje profesionalnih usluga u preduniverzitetskim edukativno-obrazovnim institucijama**<br><br>**BROJ:**<br>**DATUM:**<br><br>**Član 1**<br>**Cilj**<br><br>Cilj ove Administrativne uredbe je izbor profesionalnih službenika, za pružanje profesionalnih usluga koje obuhvata lekarsku negu, pedagošku-psihološku podršku, savetodavne i socijalne usluge. | Pursuant to article 37 paragraph 1 and 2 of the Law for pre-university education (Official Gazette no. 17 / 16 September 2011), in accordance with appendix 6 of the Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of Prime Minister's Office and Ministries (date 22.03.2011) and article 38 (6) of the rules of procedure of the Government, no. 09/2011, Ministry of Education, Science and Technology, issues this:<br><br>**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION**<br><br>**Draft administrative instruction: selection of employees for provision of professional services in pre-university instructive-education institutions**<br><br>**NUMBER:**<br>**DATE:**<br><br>**Article 1**<br>**The purpose**<br><br>The purpose of this administrative instruction is selection of professional employees for provision of professional services which include medical care, pedagogical-physiological support and consulting and social services. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Përgjegjësitë e komunës**<br><br>**1.** Komuna, obligohet që duke respektuar kriteret e rekrutimit të përcaktuara nga MASHT, të zgjedhë shërbyesit profesional: mjekun, pedagogun, psikologun, etj. në institucionet edukative dhe arsimore të arsimit parauniversitar.<br>**2.** Orari i punës rregullohet nga punëdhënësi në bashkëpunim me institucionin përkatës edukativ dhe arsimor.<br>**3.** Shërbyesit profesional duhet të punojnë 40 orë në javë<br>**4.** Në rast se institucioni përkatës siguron donacion të dedikuar për shërbyes profesional, të cekur më lartë, punësimi zyrtarizohet, pasi më parë të jenë realizuar procedurat e rekrutimit nga punëdhënësi.<br><br>**Neni 3**<br>**Shërbyesit profesional**<br><br>**1.** Një shërbyes profesional, punësohet në institucionin edukativ- arsimor nëse institucioni ka mbi 1000 nxënës/fëmijë. | **Član 2**<br>**Opštinske odgovornosti**<br><br>**1.** Opština, obavezna je poštujući kriterijume za regrutaciju određene od strane MONT-a, da izabere profesionalne službenike: lekara, pedagoga, psihologa, itd, u preduniverzitetskim edukativno obrazovnim institucijama.<br><br>**2.** Radno vreme određuje poslodavac u saradnji dotičnom edukativno-obrazovnom institucijom.<br><br>**3.** Profesionalni službenici treba da rade 40 sati nedeljno.<br>**4.** U slučaju da dotična institucija obezbedi donacije namenjene za profesionalne službenike, gore navedene, zaposlenje će biti formalizovano, tako što su ranije izvršene procedure za regrutaciju od strane poslodavca.<br><br>**Član 3**<br>**Profesionalni službenici**<br><br>**1.** Profesionalni službenik, može se zaposliti u edukativno-obrazovnoj instituciji u koliko institucija ima više od 1000 učenika/dece. | **Article 2**<br>**Municipal responsibilities**<br><br>**1.** Municipality is obliged that respecting the determined recruitment criteria form MEST, to choose professional servants; doctor, pedagogue, psychologist, etc. in instructive and educational institutions of pre-university education.<br>**2.** Working hours are adjusted from employer in cooperation with the relevant instructive and educational institution.<br><br>**3.** Professional servants should work 40 hours per week<br>**4.** In case of the relevant institution ensures donation dedicated for professional servants, mentioned above, the employment is made official, since previously are carried out recruitment procedures form employer.<br><br>**Article 3**<br>**Professional servants**<br><br>**1.** One professional servant is employed in instructive-educational institution if the institution has over 1000 student/children. |

| | | |
|---|---|---|
| **2.** Shërbyesit profesional, mund të punësohen edhe në disa institucione edukative-arsimore, të cilat bashkë e arrijnë numrin mbi 1000 nxënës/fëmijë.<br><br>**3.** Shërbyesit profesional, mund të punojnë si mësimdhënës vetëm nëse posedojnë licencë për mësimdhënie.<br><br>**Neni 4**<br>**Psikologu**<br><br>**1.** Institucioni edukativ-arsimor duhet ta ketë psikologun nëse ka mbi 1000 nxënës.<br>**2.** Psikologu i institucionit do të:<br>**2.1.** Zhvillojë profilet e nxënësve në bashkëpunim me mësimdhënësit.<br>**2.2.** Mbajë lidhjet me mësimdhënësit lidhur me nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale.<br>**2.3.** Këshillon nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillojë zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale.<br>**2.4.** Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori i institucionit dhe i punëdhënësit. | **2.** Profesionalni službenici, mogu se zaposliti u nekoliko edukativno-obrazovne institucije koje ukupno dostižu broj preko 1000 učenika/dece.<br><br>**3.** Profesionalni službenici, mogu da rade kao nastavnici samo ako imaju licencu za predavače.<br><br>**Član 4**<br>**Psiholog**<br><br>**1.** Edukativno-obrazovna institucija treba da ima i psihologa u koliko broji više od 1000 učenika.<br>**2.** Psiholog u instituciji će:<br>**2.1.** Razvijati profil učenika za saradnju sa nastavnicima.<br>**2.2.** Održavati veze sa nastavnicima u vezi učenika, koji imaju potrebu za pomoć ili imaju lične probleme.<br>**2.3.** Savetuje učenike, koji imaju potrebu za pomoć u učenje, neprekidan rad, savetuju za izbor profesije ili koji imaju potrebu za savete u prevazilaženju ličnih problema.<br><br>**2.4.** Vrši i druge obaveze određene od strane direktora institucije i poslodavca. | **2.** Professional servants could be employed also in some instructive-educational institutions, which together reach the number over 1000 student/children.<br>**3.** Professional servants, could work as teachers only if possess licence for teaching.<br><br>**Article 5**<br>**Psychologist**<br><br>**1.** Instructive-educational institution should have the psychologist if it has over 1000 student.<br>**2.** Psychologist of the institution will:<br>**2.1.** Develop students profile in cooperation with teachers.<br>**2.2.** Keeps connections with teachers regarding with student, who have need for help or have personal problems.<br>**2.3.** Advices students, who have need for assistance in learning, continuous work, advices selection of profession or which have need for advices to overcome the personal problems.<br><br>**2.4.** Performs other duties set from the director of institution and of the employer. |

| Neni 5<br>Pedagogu | Član 5<br>Pedagog | Article 5<br>Pedagogue |
|---|---|---|
| **1.** Institucioni edukativ dhe arsimor duhet ta ketë pedagogun nëse ka mbi 1000 nxënës. | **1.** Edukativno i obrazovna institucija treba da ima pedagoga u koliko broj više od 1000 učenika. | **1.** Instructive and educational institution should have the pedagogue of it has over 1000 student. |
| **2.** Pedagogu i institucionit do të: | **2.** Pedagog institucije će: | **2.** The pedagogue of institution will: |
| **2.1.** Mbajë përgjegjësinë kryesore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. | **2.1.** Snositi glavnu odgovornost za profesionalni razvoj nastavnika. | **2.1** .Keep main responsibility in professional development of teachers. |
| **2.2.** Zhvilloj profilet e nxënësve në bashkëpunim me mësimdhënësit. | **2.2.** Razvija profile učenika u saradnji sa nastavnicima. | **2.2** .Develop students profile in cooperation with teachers. |
| **2.3.** Mbaj lidhjet me mësimdhënësit lidhur me nxënësit të cilët kanë probleme në nxënie, probleme personale apo të natyrave të ndryshme. | **2.3.** Održava veze sa nastavnicima u vezi učenike koji imaju probleme u učenju, lične probleme ili probleme druge prirode. | **2.3** .Keep connections regarding with student which have problems in learning, personal problems or of different natures. |
| **2.4.** Këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillon përzgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale, arsimore etj. | **2.4.** Savetuje učenike koji imaju potrebu za pomoć u učenju, stalni rad, savetuje u izbor profesije ili koji imaju potrebu za savete u prevazilaženju lične obrazovne i druge probleme. | **2.4** .Advices students which have need for assistance in learning continuous work, advises selection of occupation or which have need for advices to overcome personal, educational problems etc. |
| **2.5.** Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori i institucionit dhe i punëdhënësit. | **2.5.** Izvršava i druge obaveze koje mu odredi direktor institucije i poslodavca. | **2.5** .Performs other duties set from director of institution and of employer. |

| Neni 6<br>**Kompetencat e MASHT-it në fushën e licencimit të pedagogëve, psikologëve, dhe sociologëve** | Član 6<br>**Kompetencije MONT-a u oblasti licenciranje pedagoge, psihologe, i sociologe** | Article 6<br>**Competences of MEST in the field of licensing of pedagogues, psychologists and sociologists** |
|---|---|---|
| 1. MASHT-i, ka përgjegjësi:<br>**1.1.** Të përcaktojë nivelin e kualifikimit profesional sipas normativit.<br>**1.2.** Të licencoj shërbyesit profesional, pedagogët, psikologët dhe sociologët.<br>**1.3.** Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM), akrediton programet për Zhvillim profesional për kategoritë e cekura më lartë.<br>**1.4.** MASHT- KSHLM, të përfshijë në databazën e licencimit shërbyesit profesional. | 1. MONT –j, e odgovoran:<br>**1.1.** Da odredi nivo profesionalne kvalifikacije prema normativima.<br><br>**1.2.** Da licencira profesionalne službenike, pedagoge, psikologe i sociologe<br>**1.3.** Državni savet za licenciranje nastavnika (DSLN) akredituje programe za profesionalni razvoj za gore navedene kategorije.<br><br>**1.4.** MONT – DSLN, da obuhvati u databaze licenciranje profesionalne službenike. | 1. MEST has responsibility:<br>**1.1** .To determine the level of professional qualification according to normative.<br>**1.2** .To licence professional servants, pedagogues, psychologists and sociologists<br>**1.3** .State Council for Teachers Licensing (SCTL), accredits programs for professional development for the above mentioned categories.<br>**1.4** .MEST-SCTL, to include in database of licensing the professional servants. |
| **Neni 7**<br>**Hyrja në fuqi** | **Član 7**<br>**Stupanje na snagu** | **Article 7**<br>**Entry into force** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri. | Ova Administrativan uredba stupa na snagu na dan potpisivanje od strane ministra | This administrative instruction enters into force with its signature by the minister. |
| **Prof. dr. Ramë Buja, ministër** | **Prof. dr. Ramë Buja, ministar** | **Prof. dr. Rame Buja, minister** |